

Stonewall

ABOUT THIS RESOURCE

This resource is produced by Stonewall, a UK-based charity that stands for the freedom, equity and potential of all lesbian, gay, bi, trans, queer, questioning and ace (LGBTQ+) people.

At Stonewall, we imagine a world where LGBTQ+ people everywhere can live our lives to the full.

Founded in London in 1989, we now work in each nation of the UK and have established partnerships across the globe. Over the last three decades, we have created transformative change in the lives of LGBTQ+ people in the UK, helping win equal rights around marriage, having children and inclusive education.

Our campaigns drive positive change for our communities, and our sustained change and empowerment programmes ensure that LGBTQ+ people can thrive throughout our lives. We make sure that the world hears and learns from our communities, and our work is grounded in evidence and expertise.

To find out more about our work, visit us at www.stonewall.org.uk

Registered Charity No 1101255 (England and Wales) and SC039681 (Scotland)

Stonewall is proud to provide information, support and guidance on LGBTQ+ inclusion; working towards a world where we're all free to be. This does not constitute legal advice, and is not intended to be a substitute for legal counsel on any subject matter.



MANUALI PËR AKSESIN E KOMUNITETIT LGBT NË DREJTËSI

Sfida ndaj dhunës nëpërmjet
angazhimit të komunitetit LGBT

MËSIMET NGA AKTIVISTËT E TË DREJTAVE TË
KOMUNITETIT LGBT NË BALLKANIN PERËNDIMOR
DHE NË MBRETËRINË E BASHKUAR

 **Stonewall**
Acceptance without exception

FALENDERIME

Në radhë të parë, dëshirojmë të shprehim falënderimet tona ndaj organizatave të shoqërisë civile për komunitetin LGBT, të cilat kanë bashkëpunuar ngushtë me ne si partnere për Programin e Aksesit në Drejtësi që nga viti 2016, dhe të cilave shpresojmë se do t'u shërbejë ky punim. Konkretisht: "Aleanca", "ProLGBT", "Qendra e Hapur Sarajevë", "Qendra e Hapur Tuzla", "Qendra për Barazinë dhe Lirinë" (CEL), "Qendra për Zhvillimin e Grupeve Sociale" (CSGD), "Qendra për Mbështetjen e Komunitetit LGBTI – Komiteti i Helsinkit", "Fronti Sabotues", "Juventas", "Queer Montenegro", "Krenaria Beograd", "Mbrojtësit e të Drejtave Civile", "Da Se Zna", "Gayten", "Labris", "Kaos GL", "Pembe Hayat", "SPoD", si dhe "Shoqata për të Drejtat e Barabarta të Komunitetit LGBTI për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë" (ERA). Falenderoj në mënyrë të veçantë ata të cilët dhanë bujarisht nga koha e tyre për të më ofruar raste studimore dhe udhëzime për hartimin e këtij teksti. Konkretisht: Biljana Ginova, Stefan Šparavalo, Antonio Mihajlov, Viktorija Bondikjova, Agim Margilaj, Rita Selimi, Jelena Colakovic, Danijel Kalezić, Jozo Blazevic, Jovanka Todorovic, Natasa Boskova, Jelena Vasiljević, Peter Rigby, Bee Bailey, Gerallt Evans, dhe Amarildo Fecanji.

U ofrojmë falënderimet tona edhe policisë dhe prokurorëve të Mbretërisë së Bashkuar, si dhe institucioneve të tyre përkatëse, të cilat kanë bashkëpunuar drejtpërdrejt me ne për të realizuar Programin e Aksesit në Drejtësi. Krahas të lartpërmendurve: Chris Hartley, Lou Provat, dhe Tatjana Arsoba.

Falenderime edhe Ministrisë së Jashtme Britanike (FCO) për financimin e këtij programi, si dhe të gjithë punonjësve individualë të FCO-së të cilët dhanë bujarisht mbështetje dhe përkushtim për ndërhyrje në vend në Mal të Zi, Shqipëri, Serbi, Kosovë, dhe Maqedoni, gjatë vitit 2017.

Falenderime edhe stafit të organizatës "Stonewall", Dominic Arnall dhe Rob Pateman, për redaktimin e këtij teksti.

MANUALI PËR AKSESIN E KOMUNITETIT LGBT NË DREJTËSI

Sfida ndaj dhunës nëpërmjet
angazhimit të komunitetit LGBT

MËSIMET NGA AKTIVISTËT E TË DREJTAVE TË
KOMUNITETIT LGBT NË BALLKANIN PERËNDIMOR
DHE NË MBRETËRINË E BASHKUAR

PËRMBAJTJE

FALENDERIME	2
HYRJE	4
KAPITULLI 1: REAGIMET E KOMUNITETIT NDAJ DHUNËS	8
KAPITULLI 2: TRANSFORMIMI I INSTITUCIONEVE	13
KAPITULLI 3: REAGIMET E INSTITUCIONEVE	18
BURIME TË MËTEJSHME	22

Nga: Claire House
Dizenjoi: Alex Long
Mars 2018

Funded by



Foreign &
Commonwealth
Office



Stonewall
Acceptance without exception

Programi i aksesit në drejtësi

Në Qershor të vitit 2016, Stonewall nisi një program dyvjeçar për trajtimin e dhunës kundër komuniteteve LGBT në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi, duke angazhuar forcat e policisë, gjyqësorin dhe institucione të tjera shtetërore në rajon dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

Partnerët tanë kanë një përvojë të gjerë në ballafaqimin me dhunën, padrejtësinë dhe sigurinë për komunitetet LGBT, dhe përfshijnë organizatat për të drejtat e komunitetit LGBT në: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Turqi, si dhe forcat policore dhe shërbimet e prokurorisë në Mbretërinë e Bashkuar.

Ky manual përmbledh disa nga studimet e praktikave më të mira nga partnerët tanë në projekt dhe i bën njohur të tyre të aksesueshme nga një audiencë më e gjerë. Ndonëse përqendrohet kryesisht në punën e organizatave për të drejtat e komuniteteve LGBT në Ballkanin Perëndimor, ai përfshin edhe disa shembuj të tjerë nga partnerët policorë dhe gjyqësorë në Mbretërinë e Bashkuar.

Kujt i drejtohet ky manual?

Ky manual u drejtohet aktivistëve të të drejtave të komunitetit LGBT në të gjithë botën, të interesuar të mësojnë më shumë mbi mënyrat se si homologët e tyre kanë kryer fushata për ndryshime pozitive në trajtimin e dhunës ndaj komunitetit LGBT.

Ai ofron edhe disa mjete për aktivistët e të drejtave të komunitetit LGBT në institucionet policore, gjyqësore dhe shtetërore, duke kërkuar mënyra të reja për të siguruar që personat LGBT të gëzojnë mbrojtje dhe përfshirje të plotë.

Ne shpresojmë gjithashtu të frymëzojmë një grup më të madh lexuesish aleatë brenda institucioneve përkatëse shtetërore dhe ndërkombëtare, sidomos në lidhje me angazhimin e komunitetit LGBT.



Montenegro Pride 2017.
Credit: Queer Montenegro

Të drejtat e komunitetit LGBT në Ballkanin Perëndimor

Komunitetet LGBT në Ballkanin Perëndimor përballen me sfida madhore ndaj të drejtave të njeriut, duke përfshirë nivelet e larta të dhunës ndaj komunitetit LGBT, mohimin e lirive bazë në praktikë, si dhe qeveritë të cilat shpeshherë hezitojnë të dëgjojnë nevojat e komunitetit. Nuk është për t'u habitur që parada e parë publike e krenarisë në Kosovë u zhvillua në vitin 2017, apo fakti që në Bosnjë dhe Hercegovinë nuk është zhvilluar ende një e tillë.

Gjatë kohëve të fundit, evente të ndryshme publike të komunitetit LGBT në rajon janë sulmuar me dhunë nga grupet ultranacionaliste, grupet fetare fundamentaliste dhe ato neonaziste. Përveç kësaj, shumë shtete hezitojnë t'u ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme policore pjesëmarrësve në fazat e planifikimit të eventeve, gjë që sjell praktikisht mohimin e lirisë së tubimit dhe organizimit të personave të komunitetit LGBT. Rastet studimore tregojnë se bashkëpunimi me shtetet për të garantuar lirinë e tubimit dhe organizimit dhe sigurinë e përgjithshme kolektive përballë dhunës për komunitetet LGBT përbën një aspekt kryesor të betejës së aktivistëve.

Megjithatë, disa vende ofrojnë tashmë mbrojtje ligjore bazë për komunitetet LGBT, si p.sh. ndalimin e krimeve të urrejtjes me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Megjithatë, siç tregojnë edhe rastet studimore, ligjet për mbrojtjen e komuniteteve LGBT shpeshherë nuk gjejnë zbatim të gjerë, dhe nuk mbështeten nga politika të efektshme. Kjo do të thotë se organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), gjenden shpesh përballë situatave ku u duhet të kryejnë punë të cilat në raste të tjera do të kryheshin nga qeveritë, si p.sh. shqyrtimi i trajtimit të çështjeve nga ana e gjykatave ose zhvillimi i protokolleve policore.

Kjo do të thotë edhe që OShC-ve dhe komuniteteve u mungon shpeshherë besimi në mbrojtjen e ofruar nga institucionet policore, gjyqësore dhe shtetërore. Kuptohet që kjo mungesë besimi mund të ketë shkaqe të thella: disa shtete e ndaluan kriminalizimin aktiv të komuniteteve LGBT vetëm pas viteve '90. Të punosh me autoritete të cilat janë mësuar t'i trajtojnë personat e komunitetit LGBT si kriminelë, dhe jo si qytetarë të barabartë me të drejta, përbën një sfidë madhore për OShC-të, dhe sjell nxitjen për ndryshime më të gjera kulturore brenda institucioneve.

Komunitetet LGBT nuk janë të vetme në përballimin e sfidave të tilla, të cilat ndonjëherë pasqyrojnë faktin se institucionet dhe praktikat demokratike në rajon janë të reja. Për shembull, rasti studimor i Maqedonisë (në fq.16) tregon se aktorët shtetërorë nuk kanë gjithmonë kontroll dhe mbikëqyrje të plotë mbi institucionet policore dhe ato të sigurimit. Qasja e aktivistëve të komunitetit LGBT për gjetjen e një zgjidhjeje më sistematike dëshmon se si përfshirja e komunitetit LGBT mund t'i shërbejë reformës më të gjerë demokratike.

Së fundi, vlen të theksohet se shumë prej arritjeve të OShC-ve për të drejtat e komunitetit LGBT janë realizuar në kuadër të tendencave më të gjera ndërkombëtare, sidomos në kuadër të integritimit në BE. Gjatë viteve të fundit, shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë qenë gjithnjë e më të gatshme të shfaqin përkushtimin e tyre ndaj të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e komunitetit LGBT, për t'u dhënë shtysë shanseve të veta për anëtarësim në BE.

Kjo do të thotë se ka një mospërputhje mes asaj çfarë thuhet në ligj dhe realitetit të dhunës dhe diskriminimit që përjetojnë personat e komunitetit LGBT. Ndonëse kjo nënkupton se institucionet shtetërore mund t'i nënshtrohen ndonjëherë llogaridhënies, të fituarit e zemrave dhe mendjeve të njerëzve në betejën drejt barazisë për personat e komunitetit LGBT mbetet ende një sfidë madhore.

Për të mësuar më shumë rreth të drejtave të komunitetit LGBT në Ballkanin Perëndimor, shihni ERA Online Resource Centre e cila përmban informacione të hollësishme për secilin vend. www.lgbti-era.org/online-resource-center



Angazhimi i komunitetit LGBT

Rëndësia kritike e angazhimit të komunitetit LGBT në trajtimin e dhunës del në pah në secilin prej rasteve studimore; ndryshimi nuk mund të ndodhë pa fuqizimin e komuniteteve LGBT për njohjen, denoncimin, evidentimin, të folurit hapur, dhe shtyrjen e reformave institucionale dhe programeve të cilat i kundërpërgjigjen dhunës dhe padrejtësisë.

Herë pas here, shohim se OShC-të dhe aktivistët për të drejtat e komunitetit LGBT brenda institucioneve sjellin ndryshime të efektshme duke:

- Kuptuar, evidentuar dhe shprehur qartë përvojat e komuniteteve LGBT të cilat përballen me dhunën dhe diskriminimin.
- Refuzuar të lihen jashtë kur institucionet fillojnë të hapen.
- Ushqyer përkrahje të vazhdueshme dhe afatgjatë si dhe duke krijuar aleanca.
- Ndërthurur taktikat e 'brendshme' për të garantuar akses dhe shfrytëzim, me taktikat e 'jashtme' për të garantuar llogaridhënie dhe përfshirje.


Ky mund të jetë një projekt i ndjeshëm, sidomos kur bashkëpunohet me institucionet dhe aktorët shtetërorë, të cilëve edhe vetë ideja e bashkëpunimit me shoqërinë civile si një partner i barabartë mund të duket e re dhe e diskutueshme.

Përkrahja e tipit të vjetër

Nuk mund të theksohet aq sa duhet fakti se përkrahja e vazhdueshme dhe afatgjatë e OShC-ve për të drejtat e komunitetit LGBT, të cilat veprojnë në nivelin kombëtar, nuk është thjesht e domosdoshme, por është me shumë gjasa ndërhyrja më e efektshme në lidhje me dhunën kundër komunitetit LGBT.

Natyrisht, organizatat nuk mund të influencojnë çdo gjë. Ndër faktorët më të gjerë në rastet studimore përfshihet anëtarësimi në BE, ndryshimet në qeveri dhe aftësia e ndryshueshme e shoqërisë civile për të shfrytëzuar mbështetje nga ana e komunitetit ndërkombëtar. Mund të jetë i efektshëm edhe përqendrimi tek mbështetja e komuniteteve LGBT dhe aleatëve të tyre brenda institucioneve, për t'u lejuar atyre të promovojnë vetë barazinë – ashtu siç tregohet kryesisht në Kapitujt 2 dhe 3.

Sidoqoftë, pa praninë e OShC-ve për të drejtat e komuniteteve LGBT, të cilat janë të afta të ruajnë një agjendë gjithëpërfshirëse në planin afatgjatë, ndryshimet institucionale (nëse ndodhin vërtet) nuk do të kenë ndikim, qëndrueshmëri dhe llogaridhënie. Ndërsa aktorët policorë, gjyqësorë, të sigurimit dhe shtetërorë po e shtrijnë punën e tyre në plan global dhe po angazhohen gjithnjë e më shumë në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT, ruajtja e rolit kryesor të vetë komuniteteve LGBT në këtë çështje është më jetësore se kurrë.



Akresi i komunitetit LGBT në drejtësi

Ky nuk është një manual kundër krimeve të urrejtjes. Krimi i urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes me bazë Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinator (SOGI) janë çështje kritike për t'u trajtuar, sidomos kur kundërshtohet edhe vetë ekzistenca e dhunës kundër komuniteteve LGBT. Kur komunitetet LGBT heshtin në lidhje me dhunën, ose kur provat lihen në harresë, kjo tregon shpesh se sa thellë fshihet problemi.

Ky manual thekson punën më të gjerë që bëjnë OShC-të dhe institucionet për trajtimin e dhunës dhe për përmirësimin e drejtësisë dhe sigurisë për komunitetet LGBT. Ai përqendrohet kryesisht në përfshirjen e komuniteteve LGBT dhe në marrjen e tyre në konsideratë nga institucionet policore, gjyqësore dhe shtetërore, me qëllim që të mundësohet një ndryshim sa më i gjerë. Kjo për arsye se nëse aktorët policorë dhe gjyqësorë dhe politikëbërësit nuk perceptojnë dot një rol më të gjerë për veten dhe për institucionet e tyre në garantimin e barazisë së komuniteteve LGBT – përtej kimit të urrejtjes me bazë SOGI – ky mund të përbëjë një tregues tjetër se sa thellë fshihet problemi.

Cila është struktura e këtij manuali?

KAPITULLI 1. REAGIMET E KOMUNITETIT

Mbulon:

Reagimet e komunitetit dhe të OShC-ve për komunitetin LGBT ndaj dhunës, duke përfshirë fushatat, përkrahjen, dokumentimin, kërkimet dhe organizimin e komunitetit.

Rëndësinë e punës së drejtpërdrejtë me komunitetet për të nxitur njohjen dhe denoncimin e dhunës, si dhe për të zhvilluar një bazë provash për të mbështetur reformën e politikave (shih te Serbia fq.12 dhe Maqedonia fq.11).

Mënyrën se si bisedimet rreth lirisë nga dhuna dhe garantimi i sigurisë mund të jenë të rëndësishme kur bëhet thirrje për të drejta dhe vëmendje (shih te Maqedonia fq.8–9 dhe Kosova fq.12).

KAPITULLI 2. TRANSFORMIMI I INSTITUCIONEVE

Mbulon:

Mënyrën se si OShC-të për të drejtat e komunitetit LGBT vazhdojnë impenjimën e tyre dhe këmbëngulin për reforma të mëtejshme pasi institucionet të fillojnë t'u kushtojnë më shumë vëmendje.

Njohuritë për kapërcimin e përçarjeve të pushtetit midis shoqërisë civile dhe shtetit, duke përfshirë identifikimin e përbashkët të pengesave së bashku me partnerë të rinj institucionalë (shih veçanërisht te Mali i Zi fq.13 dhe Serbia fq.17).

Rëndësinë e gjetjes së zgjidhjeve sistematike, sidomos përballë vështirësive të tilla si qëndrimet diskriminuese dhe mungesa e bashkërendimit.

Parashtrimin e thirrjeve për të drejtat e komunitetit LGBT në mënyrë të tillë që ato të kuptohen nga ana e aktorëve policorë dhe gjyqësorë, dhe që të mund të integrohen në kulturën e tyre institucionale.

Vlerën e “përkrahjes së pandërprerë” nga ana e OShC-ve kombëtare (shih veçanërisht te Bosnja dhe Hercegovina fq.14).

KAPITULLI 3. REAGIMET INSTITUCIONALE

Mbulon:

Këndvështrimet e përkrahësve të barazisë për komunitetin LGBT dhe aleatëve të tyre të cilët punojnë brenda institucioneve policore dhe gjyqësore. Krijimin e rrjeteve të stafit LGBT, duke përfshirë rolet që ata mund të luajnë për të garantuar përfshirjen dhe diversitetin.

Mënyrat se si angazhimi i komunitetit LGBT mund të shërbejë si mjet për të rritur cilësinë e shërbimit dhe transparencën e institucioneve policore dhe gjyqësore, duke siguruar mbikëqyrjen dhe duke nxitur besimin e publikut të gjerë.

Në njëfarë mënyre, Kapitulli 3 na rikthen në pikën fillestare; angazhimi i komunitetit LGBT nuk është jetik thjesht për ato komunitete të cilat përjetojnë dhunën, por u shërben edhe institucioneve të cilat synojnë të sigurojnë drejtësinë për të gjithë.



KAPITULLI 1: REAGIMET E KOMUNITETIT NDAJ DHUNËS

Reagimet e komunitetit ndaj sulmeve kundër Qendrës për Mbështetjen e Komunitetit LGBTI në Maqedoni

– Qendra për Mbështetjen e Komunitetit LGBTI, Komiteti maqedonas i Helsinkit – www.lgbti.mk

Që nga muaji tetor 2012, gjashtë sulme kanë ndodhur kundër stafit të zyrave të Qendrës për Mbështetjen e Komunitetit LGBTI, duke përfshirë dy raste ku njerëzit kanë mbetur të plagosur rëndë, dy sulme me zjarrvënie të qëllimshme, si dhe dy të cilat rezultuan në shembjen e zyrave të tyre.

Gjatë një sulmi në vitin 2013, policia në zyrat e tyre nuk arriti të ndërhynte për të mbrojtur 40 anëtarët e pranishëm të komunitetit. Deri sot, nuk është dënuar as edhe një person i vetëm, pavarësisht përhapjes së gjerë të lajmeve në media dhe përpjekjeve të forta përkrahëse nga ana e lëvizjes maqedonase.

Sulmet u kanë dhënë formë reagimeve të lëvizjes maqedonase për të drejtat e komunitetit LGBTI. Një prej organizatorëve, Biljana Ginova, shpjegoi se si sulmet kanë shërbyer si shtytje për fushata krijuese, si dhe për thirrje më të gjera për të drejta në çështje të tjera në nivel kombëtar:

“Sulmi i fundit dhe i gjashtë në vitin 2014 ndodhi në një lokal pranë vendit ku Qendra për Mbështetjen e Komunitetit LGBTI po festonte përvjetorin e saj – së bashku me partnere, OJQ, ambasadorë, etj. – dhe u sulmua sërish me gurë dhe shishe, etj. Sulmi ishte mjaft i gjatë dhe të gjithë ishin mbyllur brenda. Disa njerëz pësuan sulme paniku dhe ngjiteshin në mure – shumë prej tyre nuk i përkisnin komunitetit LGBTI. Në njëfarë mënyre, ata kuptuan më në fund se ç’do të thotë të jesh pjesë e komunitetit LGBTI në Maqedoni, dhe mendoj se është pikërisht kjo ajo që tërhoqi më shumë vëmendje. Por megjithatë, komuniteti mbeti i vetëm, me shumë pak aleatë.”

Pas sulmit të gjashtë, ata filluan protestat.

Organizatorët nuk kishin kapacitetin për të organizuar një protestë të madhe, sepse “të themi të vërtetën, nuk janë të shumtë njerëzit të cilët nuk do të trembeshin për jetët e tyre nëse do të dilnin në protestë ... gjë që natyrisht e mirëkuptojmë”, ndaj ata vendosën të vinin në punë kreativitetin, duke përdorur taktika fushatash të cilat kërkonin më pak pjesëmarrës. Ata filluan të protestonin përpara Zyrës së Prokurorisë, çdo të enjte, duke përkujtuar ditën e sulmit më të fundit, duke u shtrirë me qese të zeza trupi përpara godinës: “ashtu, sepse kështu ishim ne ... thjesht donim të informoheshim mbi statusin e hetimeve’. Sërish, nga ana e qeverisë nuk pati asnjë reagim konkret.



Protestë jashtë Zyrës së Prokurorisë në Shkup, 2014. Meritat për foton: Qendra për Mbështetjen e Komunitetit LGBTI

Në të njëjtën kohë, Qeveria Maqedonase paraqiti një propozim për një amendament ndaj Kushtetutës për kufizimin e partneritetit civil dhe martesës në një bashkim midis një burri dhe një gruaje. Biljana shpjegoi që pikërisht në këtë moment u bashkua komuniteti. Ata transferuan Qendrën për Mbështetjen e Komunitetit LGBTI në një zyrë tjetër dhe brenda natës ajo u shndërrua në selinë e një fushate të re anti-homofobike, ku njerëzit takoheshin përditë.

Ata u ndanë në katër ekipe:

- Ekipi ligjor kreu një analizë të plotë krahasuese për çdo vend në rajon lidhur me amendamentin kushtetues
- Ekipi mediatik vuri në shënjestër median vendore në veçanti dhe krijoi sloganin: “Çfarë rrezikohet? Martesa juaj apo jeta jonë?” Organizatorët komentuan: “E vetmja gjë që kërkonim ishte respektimi i të drejtës sonë për të jetuar. Vetëm kaq kërkonim dhe përdorëm këtë hapësirë për të folur për dhunën me të cilën po përballëhim.”
- Ekipi i përkrahjes mobilizoi shpejt komunitetin ndërkombëtar
- Ekipi i katërt u përqendrua në komunitetin dhe krijoi disa nëngrupe për të përkrahur kauzën në parlament, ku u duhej vetëm një votë për të hedhur poshtë amendamentin kushtetues. Duke pasur vetëm pak kushte për t’iu drejtuar të gjithëve, ata veçuan gjashtë persona që mendonin se mund t’u ndryshohej mendja, të cilët u vunë nën shënjestrën e secilit prej ekipeve – një avokat, një anëtar i komunitetit i cili nuk ishte aktivist, si dhe një aktivist në fund i cili do t’i përmbyllë punët.

Kur më në fund qeveria hodhi poshtë propozimin, për arsye të cilat përfshinin zhvillime më të gjera politike, komuniteti LGBTI festoi një fitore. “Si një triumf ndaj dhunës me të cilën përballëhim çdo ditë, kjo na shndërroi nga viktimat në fitimtarë”. Duke vështuar pas në kohë, Biljana rikujtoi:

“Natyrisht, gjatë sulmeve ne organizuam fushata të cilat ishin gjithashtu të suksesshme. Por më i rëndësishëm ishte fakti që filluam të punonim mbi çështje më masive dhe më strategjike. Në qoftë se nuk përqendrohemi mbi të drejtat më të gjera, dhuna do të vijë duke u shtuar. Dakord, nuk mund të bindim prokurorinë që të merret me çështje individuale, por ama mund të ndikojmë në një proces më të gjerë, i cili në fakt është më i madh.”



Belgrade Pride 2014

Njohja dhe denoncimi nga komuniteti në Beograd

- Da Se Zna! - www.dasezna.lgbt

Shoqata “Da Se Zna!” (Le ta dinë të gjithë!) inkurajon komunitetet LGBT të njohin, denoncojnë dhe flasin hapur për dhunën. Kjo shoqatë përditëson një portal në internet ku komunitetet mund të denoncojnë dhunën, dhe ofron këshillime, mbështetje ligjore, dhe përkrahje për viktimat. Duke bashkëpunuar ngushtë me komunitetet LGBT, duke organizuar ngjarjet komunitare dhe duke reklamuar gjerësisht punën e tyre në media sociale, ajo kryen edhe kërkime mbi çështjet e dhunës kundër komunitetit LGBT, më gjerësisht në Serbi.

Në vjeshtë të vitit 2015, “Da Se Zna” ishte në thelb thjesht një faqe në internet për denoncimin e dhunës (ose për denoncimin nga palët e treta). Por nga fundi i vitit 2015, anëtarët e stafit kuptuan se kishin nevojë të krijonin një organizatë për të përballuar numrin e madh të kërkesave. Ashtu siç komentoi edhe një anëtar i stafit, Stefan Shparavalo:


“Ç’kuptim ka portali nëse nuk ke dikë që të të përgjigjet? Pra, duhet të kesh njerëz të punësuar me orar të plotë të cilët do të kenë mundësi t’u ofrojnë ndihmë njerëzve, të kontaktojnë policinë ose t’i shoqërojnë njerëzit në rast se ata ndihen të pasigurt nëse shkojnë në polici të pashoqëruar.”

Krijimi i organizatës mori shkas edhe nga reagimet e aktivistëve ndaj sulmeve me profil të lartë. Aktivistja e mirënjohur e komunitetit LGBT Dragoslava Barzut, e cila së bashku me mikeshat e saj u dhunua gjatë një krimi urrejtjeje në Beograd në shtator 2015, iu bashkua “Da Se Zna” në këtë fazë. Rasti i Dragoslavës, si dhe mungesa e reagimit institucional paraqet një mënyrë tjetër për të perceptuar rritjen e fuqishme të një organizate e cila del drejtpërdrejt në mbrojtje të viktimave, duke gjetur njëkohësisht edhe zgjidhje më të gjera.

Në tërësi, Stefani nënvizoi punën e “Da Se Zna” pranë komunitetit, si dhe qasjet e tyre më të gjera, duke përfshirë dhe çështjet gjyqësore strategjike. Për shembull:

“Ne morëm përsipër çështjen e një gruaje transgjimore [d.m.th. një burrë i lindur i kthyer në grua – shën. përk.] nga Valjevo, e cila u rrah rëndë nga një mashkull. Në mbrojtje të tij, personi ca cituar ndër të tjera se ishte acaruar nga fakti që ajo ishte vishur si grua. Kështu, në këtë rast, motivi i tij është mjaft i qartë. Megjithatë, gjykata lokale nuk mori parasysh Nenin 54a.¹ Avokatët as nuk ishin në dijeni se ky nen mund të zbatohet. Përkundrazi, ai u gjykua dhe u dënua vetëm për prishjen e rendit publik, dhe fitoi lirim me kusht për vetëm një vit. Në mbrojtje të tij u citua gjithashtu fakti se ishte njeri familjar dhe kishte dy fëmijë. Pas kësaj, ne paraqitëm një kërkesë për një Iniciativë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë ... Pas tre muajsh kjo iu parashtrua Gjykatës së Lartë të Serbisë. Kjo e fundit ose mund t’ia kthejë çështjen gjykatës lokale ose mund të nxjerrë një vendim të ri. Tani jemi në pritje të rezultatit dhe shpresojmë se kjo do të jetë ndjekja e parë penale në Serbi për një krim urrejtjeje me bazë SOGI.”

¹ Neni 54a i Kodit Penal të Serbisë penalizon krimet e urrejtjes me baza të ndryshme, duke përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor.



Kerkmime nga Fronti Sabotues, 2017. Meritat për foton: Fronti Sabotues

Kërkimet dhe përkrahja e bazuar në prova në Maqedoni

– Fronti Sabotues – www.s-front.org.mk/en/

“[Kërkimet] sigurojnë të dhëna shkencërisht të sakta, me qëllim që politikëbërësit të mund të kuptojnë, përtej provave individuale dhe organizative, se cilat janë nevojat e komunitetit, si dhe trajtën e politikave të efektshme.” – Antonio Mihajlov, Fronti Sabotues

Në Prill 2016 dhe Dhjetor 2017, Shoqata Maqedonase për një Qasje Kritike ndaj Gjinisë dhe Seksualitetit, Fronti Sabotues, botoi dy relacione të reja kërkimore. I pari, “*Diskriminimi, Dhuna dhe Keqtrajtimi i të Rinjve të Komunitetit LGBTI në Maqedoni*”,² fokusohet në eksperiencat e dhunës dhe të diskriminimit me të cilat përballen të rinjtë. Duke u nisur nga anketat e kryera me 552 të rinj, duke përzgjedhur grupe në internet dhe në terren, ky relacion përfshin si të anketuar edhe anëtarë të komunitetit LGBT edhe persona të tjerë që nuk janë pjesë e këtij komuniteti.

Relacioni i dytë, “*Pa ligje, asgjë nuk ka vlerë*”,³ fokusohet në nevojat kryesore të komuniteteve LGBT dhe në shërbimet e ofruara nga OSHC-të për komunitetet LGBTI në Maqedoni. Sipas një anëtareje të stafit të Frontit Sabotues, Viktorija Bondikjova: “Ajo çfarë mësuam nga relacioni është fakti që dëgjuam vërtet zërat e komunitetit. Kjo ishte mjaft e gjithanshme. Ne e bëmë këtë në qytete të ndryshme, dhe ishte hera e parë që arritëm të rekrutim 81 anëtarë të komunitetit dhe aktivistë të shoqërisë civile të cilët morën pjesë në intervista dhe fokus grupe.” Relacionet janë një prej shembujve të pakët të projekteve kërkimore në shkallë të gjerë në rajon të realizuara nga një OJQ LGBT.

Fronti Sabotues organizoi takime për të paraqitur konkluzionet, gjë që shërbeu si bazë për bisedime të informuara midis politikë-bërësve kryesorë, si p.sh. Dhoma e Psikologëve Maqedonas, si dhe përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikave Sociale, dhe organizatat ndërkombëtare.

Relacionet tregojnë gjithashtu se të rinjtë e komuniteteve LGBTI përjetojnë katër herë më shumë dhunë fizike sesa të rinjtë që nuk i përkasin komuniteteve LGBTI, dhe përjetojnë nivele më të larta vetëfshetjeje, ankth gjatë ndërveprimit social, si dhe diskriminim të përditshëm. Të dy relacionet theksuan nevojën për reforma ligjore dhe në drejtësi. Për më tepër, përgjigjet cilësore ofruan mundësi për çuarjen përpara të disa çështjeve, si p.sh. ato që kishin të bënin me zhvatjen nga forcat policore, si dhe me përdorimin e të ashtuquajtura terapi shndërrimi nga ana e profesionistëve të shëndetit mendor.

Një anëtar i stafit, Antonio Mihajlov, u shpreh se “relacionet evidentuan një nevojë shumë të madhe për sa i përket shëndetit mendor të të rinjve të komunitetit LGBTI, si dhe shërbimet e shëndetit mendor që u nevojiten atyre ... politikë-bërësit ishin të interesuar për konkluzionet.”

Projekte të tjera kërkimore në shkallë të gjerë, me të dhëna kyç mbi dhunën dhe diskriminimin kundër personave të komuniteteve LGBT në rajon, përfshijnë një projekt të Institutit Demokratik Kombëtar (NDI) nga viti 2015, si dhe kërkimet e ardhshme nga ana e Bankës Botërore, në bashkëpunim me Shoqatën për të Drejtat e Barabarta të Komuniteteve LGBTI për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (ERA).

² Stojanovski, Kristofer – “Subversive Front” (2016) <http://s-front.org.mk/wp-content/uploads/2016/04/Report-from-the-survey-on-SOGI-based-discrimination-violence-and-bullying-among-youth-in-Skopje.pdf>

³ Stojanovski, Kristofer – “Subversive Front” (2017) <http://s-front.org.mk/en/2017/12/12/procena-na-potrebite-na-lgbtlugjeto-vo-rm/>



Parada e “Krenarisë” në Prishtinë

– CSGD – www.csgd-ks.org

Më datë 10 tetor 2017, në Kosovë u zhvillua parada e parë e krenarisë. Mbi 500 pjesëmarrës marshuan nëpër rrugët e Prishtinës, të shoqëruar nga përfaqësues të nivelit të lartë, duke përfshirë edhe Presidentin. Parada u festua si një sukses i madh nga ana e lëvizjeve kosovare dhe rajonale të komuniteteve LGBT, dhe kaloi pa asnjë incident të dhunshëm.

Një nga pikat interesante në Paradën e Krenarisë në Prishtinë ishte mungesa e forcave të dukshme policore të sigurimit. Patrullimi policor gjatë ngjarjeve të tilla në rajon përbën ndonjëherë një çështje të debatueshme, si brenda ashtu edhe jashtë komunitetit LGBT. Janë zhvilluar një sërë paradash krenarie ku policët kanë qenë më të shumtë në numër sesa vetë pjesëmarrësit, duke pasqyruar kështu thellësinë e dhunës anti-LGBT në rajon, si dhe ngurrimin e shteteve për të mbrojtur lirinë e shprehjes dhe të tubimit dhe organizimit, pa përdorur taktika të vrazhda policore. Marshuesit e Paradës së Krenarisë në Beograd në vitin 2014, për shembull, u shoqëruan nga tanke nga të dy anët.⁴ Strategji të tjera më të lehta përfshijnë rrethimin nga policia të zonës së qytetit përmes së cilës parashikohet të kalojë parada, si dhe dislokimin e forcave policore në pika strategjike përgjatë rrugës së planifikuar.

Si bashkëpunuan me policinë grupet kosovare, duke përfshirë CSGD dhe CEL, për të zhvilluar strategjinë e tyre? Sipas një anëtari stafi të CSGD, Agim Margilaj:

“Ne filluam me pikën e kontaktit të policisë për komunitetin LGBT, pastaj bisedimi kaloi në një nivel më të lartë me Drejtorët e Policisë dhe të Njësitë të Veçanta ... ata nuk patën asnjë kundërshtim lidhur me paradën. Ata nuk bënë asnjë pyetje, për shembull, për arsyet e organizimit të kësaj parade. E vetmja gjë që kërkuam ishin hollësitë, si dhe fakti që duhet t'i bindeshim rreptësisht orarit për shkak të procesit të tyre të sigurisë, të cilin ne e respektojmë ... Ne i këshilluam se nuk donim të ngriheshin barrikada rreth paradës ... dhe ata na thanë “jo, është në rregull, nuk duam të kufizojmë lirinë e lëvizjes”.

Ne bashkëpunuam me ta gjatë gjithë kohës. Ata bënë një vlerësim risku dhe monitoruan sulmuesit potencialë, dhe [përgatitën] mënyrat e mundshme të ndërhyrjes së tyre, duke përfshirë dhe një analizë të aktiviteteve të tyre në media sociale, etj., gjë që rezultoi pozitive. Ne u përfshimë madje edhe në hartimin e planit të tyre të sigurisë, d.m.th. biseduam për mundësinë e ndonjë sulmi nga pikënisja, si dhe gjatë rrugës, [duke pyetur] nëse do të ndodhte ndonjë sulm – çfarë do të bënim ne?”

Agimi shtoi se “meqë parada ishte një ngjarje aq masive”, pasi siguruan angazhimin e nivelit më të lartë të qeverisë për të mbështetur ngjarjen, ata patën më shumë bashkëpunim me policinë. Bashkëpunimi u mundësua edhe për shkak se policia në Prishtinë kuptoi se kishte nevojë të bashkëpunonte me komunitetet LGBT për të garantuar ecurinë e ngjarjes pa pengesa.

Çfarë i ndihmoi ata të fitonin angazhimin e qeverisë?

“Pjesë e mesazheve tona ka qenë fakti se këto parada përbëjnë një mjet të rëndësishëm për të matur përkushtimin e shteteve ndaj barazisë së komuniteteve LGBT ... U shprehëm qartë se nëse ndodhte ndonjë gjë, ngjarja mund të interpretohej shumë keq në kuadër të integritetit evropian e kështu me radhë ... [çfarë këshille do të jepja unë?] Në terma diplomatikë, do të thosha: bashkëpunoni me politikanët tuaj!”

⁴ <https://www.amnesty.org.uk/blogs/lgbti-network/serbia-belgrade-pride-we-finally-walked-ljudi-za-ljude>

KAPITULLI 2: TRANSFORMIMI I INSTITUCIONEVE

Montenegro Pride 2017.
Credit: Queer Montenegro

Puna policore në Malin e Zi

– Juventas – www.juventas.co.me dhe Queer Montenegro - www.queermontenegro.org

Bashkëpunimi i shoqatave “Queer Montenegro” dhe “Juventas” me policinë filloi në vitin 2010, pasi bënë kërkime për nevojat e komunitetit LGBT. Një anëtare e stafit të “Juventas”, Jelena Colakovic, sqaroi se:

“Kjo përfshinte bashkëpunimin me policinë, pasi ishte e dukshme... Në thelb, projekti ngriti bazat për gjithçka bëjmë sot. Ky kërkim na tregoi se [komunitetet LGBT] nuk kishin mjaftueshëm besim – sidomos te funksionarët publikë. Ai tregoi se dhuna dhe diskriminimi kundër komuniteteve LGBT ishin të larta, dhe se në shumicën e rasteve policia nuk po i hetonte mirë çështjet. Dhe në vitin 2011 kjo u përforcua kur konstatuam se policia nuk po ndiqte penalisht çështjet e hetuara.”

Bashkëpunimi i tyre me policinë u vendos plotësisht në vitin 2013, kur të dyja grupet bashkëpunuan për të organizuar paradën e parë të krenarisë në Podgoricë. “Kjo ishte hera e parë që u ulëm dhe komunikuan në mënyrë mjaft të respektueshme. Kishim diçka për të cilën mund të bashkëpunonim me ta”.

Në ngjarje u dislokuan 2000 policë për të garantuar sigurinë e pjesëmarrësve, pasi 1500 kundër-demonstrues ishin mbledhur gjithashtu për t'u përpjekur ta prishnin ngjarjen me dhunë. Në tërësi, ngjarja u përgëzua si një sukses madhor për lirinë e tubimit dhe organizimit të komuniteteve LGBT nëpër rajon. “Juventas” dhe “Queer Montenegro” kanë vazhduar të bashkëpunojnë ngushtë me policinë për të zhvilluar strategjinë e sigurisë në paradat e krenarisë, numri i të cilave është rritur vit pas viti.

Bashkëpunimi i organizatave me institucionet policore dhe gjyqësore është rritur vazhdimisht që nga ajo kohë. Për shembull, në vitin 2012, ato filluan të jepnin udhëzime dhe trajnime për policinë – iniciativa të cilave iu desh mjaft kohë për të fituar mbështetjen e Drejtorisë së Policisë. Tashmë ato bashkëpunojnë edhe me prokurorët dhe gjykatësit, dhe gjithnjë e më shumë i bashkojnë me policinë, gjë që mund të ndihmojë për të siguruar që institucionet të mos i delegojnë përgjegjësi njëri-tjetrit, ose 'sistemit më të gjerë', ku çështjet trajtohen pa kujdes. Modeli i trajnimit i cili përdoret nga të dy organizatat përdor një sërë qasjesh të ndryshme kreative për të rritur ndjeshmërinë ndaj komuniteteve LGBT, për të nxitur reflektimin e sinqertë mbi rolin e gjithsecilit në diskriminim, si dhe për të inkurajuar një dialog të hapur nga ana e policisë, prokurorëve dhe gjykatësve lidhur me veprimet që ata mund të ndërmarrin. Një pjesë thelbësore e qasjes së tyre, për shembull, është ndërmjetësimi për t'i dhënë hapësirë policisë, prokurorëve dhe gjykatësve të shprehin hapur përvojat e tyre në lidhje me diskriminimin, dhe t'i lidhin këto përvoja me ato të komuniteteve LGBT.

Duke rikujtuar etapat e tjera të punës së tyre, Jelena theksoi edhe rëndësinë e përkrahjes së ofruar prej tyre për krijimin e strukturave kyç brenda sistemit të drejtësisë penale, si p.sh. ndryshimi i kurrikulës së Akademisë Policore dhe rekrutimi i nëpunësve për lidhje me komunitetin LGBT:

“Por problemi [me këta nëpunës] mbetet ende fakti se shumë njerëz nuk janë në dijeni për ta ... Për shembull, ka pasur disa iniciativa të mëparshme për reklamimin e roleve ... por disave prej tyre u ka munguar mbështetja nga eprorët ... Një problem tjetër është fakti që vetë nëpunësit e lidhjes me komunitetin LGBT shpeshherë nuk dëshirojnë të shquhen.”

Grupet kanë bashkëpunuar edhe për disa iniciativa më të gjera, duke përfshirë ngritjen e një “Ekipi Besimi”, të themeluar në vitin 2016. Ky ekip u krijua me synimin për të mbështetur koordinimin ndërrikasterial, si dhe angazhimin dhe mbikëqyrjen e komunitetit LGBT, lidhur me trajtimin e çështjeve të dhunës dhe të drejtësisë në lidhje me komunitetin LGBT në Malin e Zi. “Megjithatë, ky ekip ka [ende] nevojë për mbështetje shtesë në mënyrë që të arrijë të veprojë siç duhet – nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë.” Në përgjithësi, Jelena theksoi rëndësinë e të vepruarit “sistematikisht, jo thjesht në mënyrë programatike”:

“Për shembull, nëse kemi një kurrikulë e cila përfshin të drejtat e njeriut të komuniteteve LGBT si pjesë përbërëse të saj, atëherë kemi një marrëdhënie më të mirë dhe një angazhim më të gjerë me policinë ... Është e rëndësishme të përfshihet këtu edhe elementi i krimit të urrejtjes, për të përmirësuar njohuritë e tyre mbi të, si dhe për të nxitur komunikimin me prokurorinë.”

Përkrahja e Vazhdueshme – Puna e Qendrës së Hapur së Sarajevës për Reformën në Drejtësinë Penale

– www.soc.ba

Sulmi në Festivalin Merlinka në vitin 2014 ka qenë me shumë gjasa ngjarja që ka nxitur përfundimin e marrëdhënieve midis Qendrës së Hapur së Sarajevës (SOC) dhe gjyqësorit. Konkretisht, në vitin 2014, 14 persona të maskuar sulmuan dhe ndërprejnë Festivalin Ndërkombëtar “Merlinka” të Filmave Homoseksualë, të organizuar nga ana e SOC çdo vit në Sarajevë. Gjatë këtij sulmi, disa persona u plagosën dhe Festivali u ndërpre. Kjo dërgoi mesazhin e fortë se shoqëria është shumë homofobike, dhe se agjencitë policore, deri në atë moment, nuk kishin kuptuar se sa të rrezikuar dhe të padëshiruar janë personat e komunitetit LGBTI në shoqëri. – Jozo Blazevic (Qendra e Hapur e Sarajevës)

Që nga viti 2012, SOC ka rritur ndërgjegjësimin ndaj dhunës kundër komunitetit LGBTI, dhe ka përkrahur reforma policore, gjyqësore dhe qeveritare. Një nga shtysat madhore për këtë punë është lufta e aktivistëve për të kthyer në realitet lirinë e tubimit dhe organizimit të komuniteteve LGBTI në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ngjarje të tjera të komunitetit LGBTI, si p.sh. Festivali Merlinka, janë sulmuar për shkak të mbrojtjes së pamjaftueshme nga ana e policisë. Ndryshe nga fqinjët e saj (Kroacia, Mali i Zi dhe Serbia), Bosnja dhe Hercegovina ende nuk ka pasur një paradë krenarie. Në vitin 2018 po diskutohet vazhdimisht për aftësitë e policisë për të mbrojtur pjesëmarrësit.

Shpjegimi i lidhjeve midis dhunës, patrullimit policor, dhe lirive themelore mbetet një pjesë kyçe e punës së SOC. Një anëtar i stafit, Jozo Blazevic, sqaroi se:

“Autoritetet në Sarajevë – me heshtjen e tyre administrative dhe duke injoruar haptazi kërkesën tonë – kanë shkelur të drejtën e lirisë së tubimit dhe organizimit për njerëzit LGBTI në Sarajevë, duke ndaluar marshimin tonë për Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë në vitin 2017. Kjo është çështja mbi të cilën ne punojmë vazhdimisht ... kryesisht me agjencitë e policisë, që ata të kuptojnë rëndësinë e garantimit të së drejtës së tubimit dhe organizimit publik të nënshtetasve të komunitetit LGBTI, që të drejtat e njeriut të personave LGBTI nuk janë të drejta të veçanta, por përbëjnë pjesë të spektrit të gjerë të të drejtave të njeriut, dhe se e drejta e tubimit dhe organizimit publik garantohet në Kushtetutë dhe mbrohet nga dokumentet ndërkombëtare.”

Që nga viti 2012, puna e SOC për çështjet e dhunës/drejtësisë ka qenë e vazhdueshme dhe e gjithanshme. Arritjet kryesore përfshijnë:

2013. Propozimi i një ndryshimi në Kodin Penal për të përfshirë krimin e urrejtjes me bazë orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Ndryshimi u miratua në prill 2016

2014. Nisja e programeve për policinë e Sarajevës lidhur me çështjet e krimeve të urrejtjes kundër komuniteteve LGBTI dhe përfshirja e çështjeve LGBTI në kurrikulën e policisë në Sarajevë, duke prekur 1500 nëpunës policie

2014. Vendosja e marrëdhënieve me katër rajone policie për të siguruar trajtim më të mirë të viktimave të komunitetit LGBT nga ana e policisë

2015. Advokimi brenda 10 ministrive të brendshme të kantoneve për trajtimin nga kurrikulat policore të çështjeve të krimit të urrejtjes kundër komunitetit LGBTI në Bosnjë dhe Hercegovinë

2017. Advokimin e suksesshëm për krijimin e një roli për lidhjen me komunitetin LGBTI dhe koordinimin lidhur me krimin e urrejtjes, brenda Zyrës së Prokurorisë në Sarajevë

Jozo theksoi disa faktorë të cilët rezultuan vendimtarë në promovimin e ndryshimeve:

Puna kërkimore dhe dokumentuese e organizatës ka rezultuar kritike: pas kontaktit fillestar me policinë – pas kërcënimeve të dhunshme kundrejt stafit të SOC në vitin 2012 – ata arritën të parashtronin të dhëna pranë Ministrisë së Brendshme lidhur me dhunën e përjetuar nga personat LGBTI, duke përdorur këtë për të justifikuar nevojën për një angazhim më sistematik.

Rëndësia e zgjidhjeve sistematike: në një kontekst ku institucionet dhe aktorët janë shpeshherë të pakoordinuar, ose ku qarkullimi i stafit është i lartë, për shembull, kërkohen zgjidhje afatgjata dhe ndërdikasteriale, siç është zhvillimi i lidhjeve të qëndrueshme midis policisë dhe prokurorëve.

Jozo theksoi edhe rëndësinë e një qasjeje pozitive, profesionale dhe bashkëvepruese: për shembull, shprehja e mirënjohjes për individët dhe institucionet kur ata i bëjnë punët siç duhet, sigurimi i ndërhyrjeve të cilësisë së lartë të cilat institucionet mund t'i integrojnë në punën e tyre, dhe krijimi i koalicionëve për të siguruar përfshirjen e të drejtave të komuniteteve LGBTI nga të tjerët (p.sh. OShC-të dhe partitë politike).



Manifestim në Beograd, i organizuar nga "Gayten – LGBT" kundër vrasjes së aktivistes turke dhe punonjëses së seksit Hande Kader, e cila u përdhunua, u rrah, u godit me thikë, u gjymtua dhe më pas u dogj me zjarr. Meritat për foton: Gayten

Përkrahja e të drejtave të transgjitorëve brenda sistemit të drejtësisë penale në Serbi

– Gayten – www.transserbia.org

"Meqenëse stafi ynë ka kontakte të rregullta me gra transgjitorë nga Padinska Skela, burgu i atij qyteti, ne jemi në dijeni të pengesave me të cilat përballen, dhe e shfrytëzuar këtë për të hartuar të gjitha politikat, gjërat bazë si p.sh. e drejta e aksesit në hormone, etj. Gjithçka që duhet të jetë tashmë e pranishme." – Jovanka Todorovic, "Gayten"

Në Shkurt 2018, "Gayten" parashtroi dy projektpropozime pranë Shtëpisë së të Drejtave të Njeriut dhe Demokracisë në Beograd. Si rezultat i një pune 18-mujore nga një ekip i vogël ekspertësh të stafit të angazhimit të komunitetit, avokatësh dhe specialistësh të përkrahjes, propozimet kishin të bënin me protokolle të reja për nëpunësit e policisë dhe të burgut lidhur me trajtimin e drejtë dhe të barabartë të transgjitorëve.

Projekti reagoi ndaj tri pikave kryesore:

1. Nevojat e komuniteteve transgjitorë lidhur me ngacmimin, trajtimin diskriminues dhe mohimin e shërbimeve dhe të drejtave nga ana e nëpunësve të policisë dhe të burgut

2. Dëshira e stafeve të "Gayten" për të ngritur bazat e punës së tyre përkrahëse të deritanishme lidhur me njohjen ligjore të gjinisë, si dhe përkushtimi i tyre i zjarrtë që angazhimi i qeverisë për të drejtat transgjitorë të ecë përpara me vrull

3. Përvoja e ekipit në angazhimin me strukturat e qeverisë, duke përfshirë hartimin e protokolleve policore

Procesi përfshiu mbledhjen dhe analizimin e përgjigjeve nga komunitetet transgjitorë lidhur me trajtimin e tyre brenda sistemit të drejtësisë penale; duke këqyruar situatën ligjore më gjerësisht për të siguruar përputhshmërinë e projekt-protokolleve me legjisllacionin në fuqi, si dhe konsultimin me grupet e interesit, duke përfshirë nëpunësit e policisë, për të dëgjuar idetë e tyre.

Procesi i nisjes kishte si synim të prekte të gjitha grupet e interesit dhe politikë-bërësit, duke përfshirë Komisionet për Mbrojtjen e Barazisë dhe të Dhënave, Avokatin e Popullit, si dhe përfaqësues kryesorë nga policia dhe Ministria e Brendshme dhe ajo e Drejtësisë. Në eventin e hapjes, të gjithë dhanë komente pozitive, dhe policia sugjeroi rishikime shtesë me fokus në procedurat e kontrolleve. Është interesante të vihet re se përgjigje të mëtejshme pozitive nga ana e politikë-bërësve përqendroheshin në efikasitetin ekonomik të propozimeve.

Hapat e radhës që do të ndërmerren nga "Gayten" janë vazhdimi i reklamimit të projektit, si dhe integrimi i rishikimeve të sugjeruara në drafte të rishikuara. Pas kësaj, këto do t'u dërgohen zyrtarëve pranë Ministrisë së Brendshme dhe asaj të Drejtësisë.

Duke vështruar pas në kohë për të kuptuar çelësin e suksesit, një anëtare e stafit të "Gayten", Jovanka Todorovic, theksoi rëndësinë e:

- Shfrytëzimit të ekspertizës ligjore dhe teknike
- Lidhjeve të efektshme me komunitetin për të siguruar që përgjigjet e politikave të pasqyrojnë nevojat
- Vlerës së kontakteve të besuara me njohuri të gjera mbi sistemin
- Përfshirjes së grupeve kryesore të interesit në një fazë të hershme.



Macedonian Police
Credit: Dickelbers

Rishikimi i materialeve të trajnimit policor në Maqedoni

- Koalicioni për të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuara
- www.coalition.org.mk

Në vitin 2012, Koalicioni bëri një rishikim të materialeve të trajnimit të cilat përdoren për të mësuar nëpunësit e rinj të policisë dhe të sigurimit në Maqedoni, duke zbuluar kështu përhapjen e pikëpamjeve diskriminuese ndaj personave të komunitetit LGBT brenda këtyre institucioneve. Tekstet që u analizuan përmbanin disa lloje stereotipash të dëmshëm. Për shembull, që homoseksualiteti është sëmundje, ose që transgjinjorët kanë prirje të kryejnë krime të dhunshme.

Duket qartë që pikëpamje të tilla janë tepër problematike, nuk gjejnë mbështetje në prova, dhe pasqyrojnë trajta më të gjera padrejtësie, ku vetë viktimat shihen si të dhunshme.

Që prej vitit 2011, Koalicioni ka bërë rishikime të ngjashme të teksteve mësimore për gjimnazet dhe universitetet, lidhur me qëndrimet homofobike dhe transfobike, si dhe me qëndrimet ndaj përdoruesve të drogave dhe atyre që jetojnë me HIV. Si pjesë e punës së tyre më të gjërë përkrahëse pranë Ministrisë së Arsimit, ata përqendrohen në identifikimin e përmbajtjeve arsimore problematike, duke argumentuar për rishikimin ose heqjen e tyre.

Koalicioni iu dha përparësi kërkimeve në fushat kryesore profesionale në të cilat personat LGBT përjetojnë diskriminim lidhur me mundësinë e aksesit në shërbimet shtetërore – drejtësia, mjekësia, psikologjia, kriminologjia, dhe arsimit.

Ata organizuan një konferencë për shtyp për të reklamuar nisjen e raportit, ku autorët, profesorët e universiteteve përkatëse dhe praktikuesit paraqitën konkluzionet e tyre. Gjithashtu, Koalicioni ngriti drejtpërdrejt shqetësimet pranë Ministrisë së Arsimit dhe asaj të Brendshme, dhe nisi ndërmarrjen e hapave pranë Komisionit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, me qëllim heqjen e përmbajtjes problematike.

Megjithatë, ndryshe nga raste të tjera ku janë identifikuar probleme të ngjashme, Koalicioni raportoi se, në këtë rast, autoritetet ishin më pak të gatshme për të ndihmuar. Disa shembuj përfshinin rastin ku Ministria e Arsimit dëgjoi shqetësimet e tyre, por sqaroi se autonominë e kësaj fushe e zotëronte Fakulteti i Sigurisë (d.m.th. Akademia Policore). Përveç kësaj, Komisioni pretendoi që autorët e teksteve shkollore kishin arsye shkencore për të shkruar ato që patën shkruar. Ministria e Brendshme u shpreh se nuk kishte autoritet për të ndërhyrë – megjithatë, Ministria ka rënë dakord të fillojë bashkëpunimin me Koalicionin për të ofruar programe trajnimi për nëpunësit policorë.

Si përgjigje ndaj kësaj, Koalicioni po kërkon tashmë një zgjidhje më sistematike. Ai është tashmë pjesë e Ekipit Kombëtar të Punës të drejtuar nga Ministria e Arsimit, për shembull, i cili po harton një ligj të ri për sistemin arsimor. Ata kanë në plan të vazhdojnë të insistojnë për reforma më të gjera nëpërmjet këtij ekipi dhe legjisllacionit arsimor, si dhe nëpërmjet legjisllacionit të ri kundër diskriminimit. Përveç kësaj, ata po bashkëpunojnë gjithnjë e më shumë me universitetet për të nxitur ndryshime. Nëse këto përpjekje do të rezultojnë të suksesshme, kjo do të nënkuptonte se universitetet do t'u duhej të merrnin në konsideratë legjisllacionin kundër diskriminimit gjatë vlerësimit se çfarë do të përfshihet ose jo në kurrikulën mësimore.

Angazhimi Policor në Serbi

– Labris – www.labris.org.rs/en/

“Të drejtat LGBT tashmë janë të integruara në protokollet policore, ndaj nëpunësit e policisë do të thonë: “opinionimi im personal nuk ka rëndësi kur një person LGBT është duke folur me mua”. Ky është një hap shumë i madh, dhe jemi të befashuar dhe të habitur, sepse patëm edhe disa reagime paragjyquese, në disa mënyra edhe ndaj vetë policisë. Kjo ishte mjaft e rëndësishme për ne.”

– Jelena Vasiljević, Labris

Aktivistët nga Labris iu drejtuan Ministrisë së Punëve të Brendshme për herë të parë në vitin 2008, në përpjekje për të bashkëpunuar me policinë. Dhjetë vite më vonë, puna e Labris tashmë përfshin:

- Ofrimin e udhëzimeve dhe trajnimit për policinë
- Sensibilizimin e komunitetit për nxitjen e raportimit
- Nxitjen e krijimit të rrjeteve të reja të stafit për komunitetin LGBT dhe policinë aleate, si dhe shtrirjen e kontaktit me homologët e tyre në vende të tjera
- Krijimin e politikave të reja kombëtare lidhur me përfshirjen e personave LGBT
- Lehtësimin e kontaktit midis policisë (për shembull, nëpunësit e lidhjes me komunitetin LGBT) dhe komuniteteve LGBT, edhe jashtë Beogradit

Ndonëse peizazhi në tërësi mbetet i karakterizuar nga përjashtimi i konsiderueshëm, tashmë ka gjithnjë e më shumë policë të cilët janë të gatshëm të shquhen si përkrahës të të drejtave të komunitetit LGBT, si dhe mbështetje më të madhe nga institucionet shtetërore.

Aktivistja e Labris, Jelena Vasiljević, nënvizoi disa faktorë kyç në promovimin e reformave:

Së pari, në vitin 2013 u krijua një qeveri e re me një qëndrim më entuziast për çështjet e të drejtave të njeriut, në kuadër të anëtarësimit në BE. Nga ana e saj, Labris hartëzoi situatën dhe vendosi të fokusohet në ligjin e ri kundër diskriminimit, për të siguruar përfshirjen e personave LGBT. Aktivistët përdorën disa lloje taktikash. Nga njëra anë, u bënë enkas “shumë të bezdisshëm”, duke dërguar për shembull rreth 100 letra formale, me qëllim që politikë-bërësit ta dinin se kush ishin. Nga ana tjetër, pasi qeveria dha miratimin e saj, Labris ishte në gjendje të paraqitej si e mirëinformuar mbi sistemin, dhe me qasje diplomatike ndaj kërkesave – për shembull duke drejtuar shumë bisedime në mënyrë private, dhe jo në media.

Jelena theksoi edhe rëndësinë e sensibilizimit të komunitetit dhe punës së raportimit. Kjo u mundësoi të krijonin një përshtypje më të qartë se si policia po ndërvepronte me komunitetet LGBT, si dhe një bazë provash. Kjo përfshinte disa çështje të cilat më vonë i paraqitën privatisht pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila kuptoi se: “ne e njohim sistemin, jemi të gatshëm ta vëmë atë në përdorim dhe po themi gjithçka një më një, pa shkaktuar trazira, dhe nuk u kërkojmë të bëjnë gjëra të cilat nuk i bëjnë dot për arsye politike.”

Në mënyrë të ngjashme, ata theksuan rëndësinë e të mësuarit rreth sistemit dhe transformimit të tij sipas kushteve të veta. Për shembull, përfshirja e të drejtave të komuniteteve LGBT në protokollet policore, si dhe portretizimi i të drejtave LGBT jo si ndonjë diskutim moral, por më tepër si një çështje teknike dhe/ose profesionale lidhur me sjelljen e duhur, drejtësinë, dhe shërbimin publik. Së fundi, ata theksuan edhe vlerën e bashkëpunimit me policinë në mënyrë konstruktive. Duke mbështetur komunitetet LGBT dhe policinë aleate në ngritjen e kapaciteteve dhe rrjeteve të tyre, për shembull, ata ishin në gjendje të shihnin institucionet nga këndvështrimi i tyre. Kjo ndihmoi në identifikimin e pengesave të mëtejshme institucionale, si p.sh. bashkërenditja me prokuroritë, dhe nxiti bashkëpunimin për trajtimin e tyre.

KAPITULLI 3: REAGIMET INSTITUCIONALE

European LGBT Police
Association Conference, 2012

Zhvillimi i Shoqatës Policore Evropiane LGBT

– Shoqata Policore Evropiane LGBT – www.lgbtpolice.eu

“Secili rrjet kombëtar policor LGBT është i ndryshëm. Për shembull, në Belgjikë, ky rrjet është një organizatë e financuar krejtësisht nga anëtarët, e cila ekziston jashtë strukturës kombëtare policore. Disa rrjete financohen nga qeveria. Në Mbretërinë e Bashkuar nuk kemi financime nga qeveria qendrore, por nga qeveritë lokale ... Holanda përbën një model të mirë sepse atje bëhet një punë e shkëlqyer për të angazhuar komunitetin – në Amsterdam, ky rrjet policor patrullon me simbolin 'Roze in Blauw' [rozë në ngjyrë blu] të qëndisur në uniformat e tyre. Ata angazhohen shumë lidhur me përkujtimin e holokaustit – janë jashtëzakonisht të impenjuar, me celularë rozë, dhe janë nëpunës shumë të përkushtuar për Lidhjet me komunitetin LGBT në Amsterdam.” – Peter Rigby, Shoqata Policore Evropiane LGBT

Në Mbretërinë e Bashkuar ekzistonte fillimisht Shoqata Policore Homoseksuale (GPA), një organizatë kjo e themeluar në vitin 1990 për të përfaqësuar anëtarët në disa forca policore nëpër Mbretërinë e Bashkuar. Ajo u krijua pjesërisht si reagim ndaj sulmeve të dhunshme ndaj komuniteteve LGBT, si dhe ndaj diskutimeve për mënyrën se si policia i kishte trajtuar këto raste. Policët LGBT të cilat ndërmerrnin hapa të ngjashëm për t'u organizuar në Evropë, identifikuan gjithashtu hendekun midis komuniteteve LGBT dhe policisë, dhe njohën rolin e policisë LGBT në kapërcimin e këtij hendeku.

Deri në fund të viteve 1990, grupet LGBT në vende të tjera ishin tashmë të interesuara për progresin e shënuar në Angli, dhe rreth fillimit të vitit 2000 në Londër, një grup policor me bazë thellësisht komunitare u mbledh në një konferencë. Duke vështruar pas në kohë, Sekretari i Shoqatës Policore Evropiane LGBT, Peter Rigby, shpjegoi se si në atë kohë lindi ideja e “uniformave blu të cilët njihnin uniformat blu”, si bazë për të krijuar rrjete ndërkuftare. Në vitin 2004 u themelua Shoqata Policore Evropiane Homoseksuale (EGPA): një organizatë “çadër” e cila shërbente për krijimin e një rrjeti të policive LGBT në vende të ndryshme.

Në vitin 2015, rrjeti i Mbretërisë së Bashkuar rinisi veprimtarinë si Rrjeti Kombëtar Policor LGBT, duke përdorur një model rajonal si pjesë të strukturës së tij, për të përfaqësuar veprimtaritë e policisë si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane. Ky model i ri funksionimi solli gjithashtu edhe një ekuilibër gjinor, thirrje më të forta për barazinë e transgjitorëve, dhe përfaqësimin e anëtarëve të komunitetit LGBT në secilën prej forcave policore të Mbretërisë së Bashkuar. Pak kohë pas këtij ndryshimi, EGPA ndoqi të njëjtin shembull dhe rinisi veprimtarinë e saj si Shoqata Policore Evropiane LGBT. Në mishërimin e saj të ri, ajo ishte më gjithëpërfshirëse (p.sh. përfshinte dhe transgjitorët) dhe formale, duke qenë se krijonte lidhje me përfaqësuesit e rrjeteve kombëtare policore LGBT në çdo vend.

Sidoqoftë, sfidat kyçe kanë mbetur në thelb të pandryshuara. Në mënyrë që të shtrihen në vende të ndryshme, këto rrjete policore përqendrohen në formimin e rrjeteve dhe në shkëmbimin e praktikave më të mira (p.sh. nëpërmjet konferencës së tyre ndërkombe të zhvillohet dy herë në vit). Me anë të ngjarjeve të kështilla, si dhe nëpërmjet reklamimit të rrjetit, ato frymëzojnë policët LGBT në vende të tjera, dhe u ofrojnë mbështetje domethënëse individëve të cilët kërkojnë të realizojnë ndryshime. Siç komentoi Peter Rigby:

Greqia përbën një shembull të shkëlqyer – një nëpunës policie nga Greqia i cili mori pjesë në një nga konferencat tona u frymëzua aq shumë nga puna e Shoqatës Policore Evropiane, sa u kthye në atdhe dhe u përpoq të ngrinte rrjetin e tij aty. Fatkeqësisht, ai u përball me një reagim të ashpër nga shtypi dhe nga eprorët e tij, por vazhdoi të këmbëngulte, gjeti kolegë të tjerë nga komuniteti LGBT dhe së bashku ata themeluan rrjetin e tyre të pavarur pasi kërkuan mbështetje nga kolegët e tyre evropianë dhe pasi shqyrtuan modelet e ndryshme në veprim.

Police with Pride at Sparkle Trans Pride.
Credit: National Trans Police Association

Zhvillimi i Shoqatës Kombëtare Policore Transgjnore (NTPA)

“Duke qenë se askush nuk kishte ndopak njohuri se si po trajtoheshin nëpunësit transgjnorë, përpara themelimit të NTPA dhe më pas papritur si Sekretari i Anëtarëve, po bisedoja me gjithnjë e më shumë nëpunës transgjnorë çdo javë, po dëgjoja rrëfimet e tyre dhe, me pëlqimin e tyre të shprehur, mblidhja këto rrëfime, duke zbuluar se cilat forca policore ishin të mira dhe cilat të këqija... [Kjo na mundësoi që të kemi] mjaftueshëm vetëbesim për të thënë: “ja ku jemi”. Këto ishin kohëra ndërgjegjësimit, gjatë të cilave kuptuam se çfarë po u ndodhte vërtet kolegëve tanë transgjnorë.” – Bee Bailey, Shoqata Kombëtare Policore Transgjnore e Mbretërisë së Bashkuar

Në mars të vitit 2018, 17 vende evropiane kanë tashmë një organizatë të njohur policore e cila përfaqëson rrjetet e stafit LGBT brenda forcave policore në vend. Mbretëria e Bashkuar është i vetmi vend që ka një organizatë kombëtare e cila i përkushtohet posaçërisht përfaqësimit të çështjeve të nëpunësve transgjnorë të policisë.

NTPA u themelua në vitin 2008, kur një grup i vogël nëpunësish dhe personesh policore transgjnore u mbledhën në mënyrë joformale dhe vendosën se duhet të krijohet një rrjet i posaçëm për transgjnorët, meqë Shoqata (e atëherëshme) Policore Homoseksuale e Mbretërisë së Bashkuar nuk dukej se ofronte ndopak mbështetje ose udhëzim në atë kohë. Rolet e NTPA përfshijnë:

Dhënien e udhëzimeve në lidhje me politikën

Praktikat më të mira dhe mbështetje individuale për nëpunësit dhe personelin policor transgjnor, si p.sh. për ata të cilët përjetojnë diskriminim transfobik në punë

Botimin e udhëzimeve mbi, për shembull atë çfarë mund të bëjnë forcat policore të Mbretërisë së Bashkuar për të promovuar përfshirjen e plotë të personelit transgjnor

Përkrahjen e reformave juridike, si për shembull reforma e suksesshme e Kodit C Shtojca L të Ligjit për Policinë dhe Provat Kriminale (1984)

Nxitjen e reformave mediatike dhe të politikave

Përparësitë e saj aktuale përfshijnë:

Zhvillimin e një politike kombëtare lidhur me tranzicionin gjinor në punë

Krijimin e programeve të trajnimit në internet, për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me transeksualitetin

Nxitjen e denoncimit të krimeve transfobike të urrejtjes

Prezantimin e masave të veçanta për të siguruar trajtimin e drejtë të transgjnoreve nga ana e prokurorëve dhe gjykatave

Bashkëpunimin me policinë në vende të ndryshme për shkëmbimin e praktikave më të mira

Gjatë viteve të para të NTPA, një grup i vogël prej rreth shtatë përfaqësuesish punuan – në mënyrë vullnetare – në një sërë rolesh. Një pjesëmarrës – Bee Bailey – theksoi rëndësinë e lidhjes midis punës mbështetëse në terren që bënin me nëpunësit individualë transgjnorë, me punën e tyre më të gjërë për të ndikuar në politika. Kjo i ndihmoi të ndërtonin një tablo të gjithanshme të përvojave të transgjnorëve në veprimtaritë policore, gjë që më pas hodhi bazat për nxitjen e reformave.

NTPA kuptoi shumë shpejt rëndësinë dhe vlerën e bashkërenditjes së punës së tyre me rolin dhe përparësitë e organeve kryesore institucionale, të tilla si NPJA [Agjencia Kombëtare për Përmirësimin e Policisë] dhe Shoqata e Shefave të Policisë, duke përparuar sipas rëndësisë së ndërtimit të rrjeteve të forta dhe empatike me nëpunësit individualë transgjnorë të cilët i mbështesnin në punën e tyre, si dhe lidhjes thuajse të natyrshme të kësaj pune me një ndjenjë të fortë përkushtimi për të mbrojtur dhe folur hapur “në interesin më të mirë të anëtarëve tanë”. Në tërësi, Bee Bailey, ish-Sekretarja e Anëtarëve, theksoi rëndësinë e bashkimit të njerëzve me opinione të përbashkëta, pavarësisht nga historiku dhe roli i tyre, si dhe rëndësinë e gjetjes së mënyrave për të lidhur dhe bashkërenduar interesat e njerëzve dhe punën që ata bëjnë.

Duke reflektuar mbi ndryshimet e 10 viteve të kaluara, Bee nënvizoi ndjenjën se dukshmëria mbetet ende një sfidë, dhe se individët vazhdojnë të përjetojnë diskriminimin transfobik, si p.sh. nga eprorët e tyre të shkallës së parë ose të dytë. Sidoqoftë:

Na telefonojnë shpesh shefa policie, organe qeveritare e madje edhe nëpunës të thjeshtë në detyrë, si dhe departamente të burimeve njerëzore, dhe bisedojnë gjatë me ne ... [ka] gjithnjë e më shumë dialog, dhe njerëzit e kuptojnë tashmë se janë vendosur disa ligje dhe standarde, dhe se organizatat do të penalizohen nëse nuk veprojnë.



Modelimi i shërbimeve policore gjithëpërfshirëse në terren

Modeli “Ki besim të bisedosh me ne” ofron një mënyrë sipas të cilës forcat policore, ose ata të cilët përkrahin reforma brenda tyre, mund të përpiqen t'i bëjnë shërbimet policore në terren të përfshijnë personat LGBT.

I hartuar fillimisht në vitin 2014 nga nëpunës policie LGBT brenda Policisë së Rrethit Staffordshire në Mbretërinë e Bashkuar, modeli iu përkushtua dy aspekteve:

- Nevojës për të shprehur qartë vlerën e përfshirjes LGBT në stafin epror, duke përfshirë edhe nga ana financiare, duke theksuar dhe komunikuar punën që po kryej tashmë nga rrjeti i stafit LGBT të Policisë së Staffordshire
- Informimin e publikut të gjerë, duke përfshirë dhe komunitetet LGBT, mbi shkallën dhe shumëllojshmërinë e përpjekjeve që po bënte Policia e Staffordshire për të siguruar një përqasje gjithëpërfshirëse

Qëllimi ishte të fitohej besimi te puna e Policisë së Staffordshire në mesin e komunitetit LGBT në tërësi, gjë që nga ana e saj do të krijonte një efekt domino duke rritur raportimin dhe angazhimin e komunitetit, dhe duke përmirësuar kështu edhe më tej punën e policisë.

Ndër të tjera, modeli u shndërrua në një fushatë posterash, e cila u zhvillua në shtypin lokal LGBT. Ai u raportua pozitivisht nga media lokale dhe tërhoqi vëmendjen mbi çështjet e të drejtave të komuniteteve LGBT në mesin e shoqatave të bamirësisë në rajon, të cilat merreshin me çështje të tilla. Modeli është ndarë me polici të tjera britanike, dhe është përdorur si mjet komunikimi nga ana e Rrjetit Policor Kombëtar LGBT të Mbretërisë së Bashkuar.

Një nga gjërat kryesore që mundëson modeli është shmangia nga tradita e përqendrimin tek çështjet LGBT si të lidhura ekskluzivisht me krimet e urrejtjes, ose nga ajo e patrullimit policor në paradat e krenarisë ose ngjarje të tjera publike. Në vend të kësaj, modeli ofron një mënyrë për të komunikuar faktin se trajtimi i një sërë krimesb, si dhe një sërë fushash të veprimtarisë së policisë, do të përfitojnë nga një qasje specifike për komunitetet LGBT.

Ai u krijua në fillim si rezultat i një përpjekjeje të thjeshtë për “stuhi idesh” nga “disa policë në terren”, siç u shprehën organizatorët. Ata theksuan faktin se shpeshherë ndodheshin nën presionin e eprorëve të tyre për të reaguuar menjëherë ndaj problemeve dhe protokolleve. Ndërtimi i këtij modeli u ofroi një mënyrë për të shpjeguar mendimet dhe strategjinë e tyre më të gjerë. Madje, duke qenë se ishin nëpunës në terren të cilët merreshin me këto çështje në mënyrë të përditshme, ata ishin në gjendje të kuptonin dhe të shprehnin problemet dhe shqetësimet e komuniteteve të cilave u shërbenin.

Krimi që prek personat LGBT+





Angazhimi i komunitetit LGBT nga ana e Prokurorisë Mbretërore në Angli dhe në Uells

Prokuroria Mbretërore (CPS) në Angli dhe në Uells ka zhvilluar disa struktura të praktikave më të mira për të siguruar angazhimin e komunitetit LGBT.

Strukturat e tyre të brendshme përfshijnë një rrjet aktiv stafi LGBT, i cili ngre çështje me të cilat përballen nëpunësit LGBT brenda prokurorisë në Angli dhe në Uells dhe nxit përfshirjen e komunitetit LGBT dhe lidhjet me komunitetin në shkallë më të gjerë. Ka gjithashtu një fokus dedikuar të drejtave të komunitetit LGBT brenda Departamentit të tyre qendror të Politikave dhe të Përfshirjes, të kryesuar nga një drejtor, dhe me vendndodhje në selinë e tyre në Londër. Këtu, nëpunësit veprojnë si udhëheqës duke marrë përsipër angazhimin e komunitetit në nivel mbarëkombëtar. Për më tepër, menaxherët rajonalë dhe lokalë të përfshirjes dhe angazhimit komunitar (ICEM) krijojnë lidhje me komunitetet LGBT rajonale dhe lokale, japin udhëzime për punën në lidhje me barazinë dhe shumëllojshmërinë, dhe bashkëpunojnë me koordinatorët për luftën kundër krimit të urrejtjes.

CPS ka gjithashtu dy struktura kryesore të jashtme për të siguruar angazhimin e komunitetit LGBT.

Forumi i Llogaridhënies ndaj komunitetit (CAF) përbëhet nga përfaqësues të komuniteteve kryesore të marginalizuara në nivel kombëtar. Kryesuar nga Drejtori Ekzekutiv i CPS, detyrat e tij përfshijnë këshillimin e vendimeve kombëtare strategjike lidhur me barazinë dhe shumëllojshmërinë në përgjithësi.

Panelet Lokale të Mbikëqyrjes dhe Përfshirjes (LSIP), kanë qenë duke rishikuar çështje penale të kohëve të fundit, të shqyrtuara nga CPS gjatë dhjetë viteve të fundit. Anëtarët e panelit përbëhen nga përfaqësues të interesuar nga çdo pjesë e spektrit të diversitetit, të cilët rishikojnë çështje penale të kohëve të fundit të marra në shqyrtim nga CPS. Për shembull, anëtarët mund të përfshijnë përfaqësues të komunitetit transgjinnor, të cilët mund të identifikojnë faktorë diskriminues në mënyrat e marrjes në pyetje gjatë fazës hetimore. Çështjet e përzgjedhura për rishikim synohen të jenë përfaqësuese, për shembull, ndonjë herë ato përzgjidhen nga një konsulent ligjor i pavarur. Si rezultat, sistemi funksionon në mënyrë efektive si një “kontroll i çastit” mbi veprimet institucionale, duke qenë se, në parim, çdo çështje me të cilën merret CPS mund të përzgjidhet për rishikim.

Para se të ngrihet një panel i ri mbikëqyrës, CPS bën kërkime në terren së bashku me përfaqësues kryesorë nga komunitete të marginalizuara, për të ndërtuar një panel anëtarësh. Këta mund të jenë si anëtarë të komunitetit, ashtu edhe persona me përvoja të caktuar, si p.sh. persona që janë marrë me çështje të krimeve të urrejtjes.

Në njëfarë mënyre, qasja dhe funksioni janë të ngjashme me ato të Grupeve Këshilluese të Pavarura të policisë britanike (IAG). Meqë synohen të përbëhen nga anëtarë përfaqësues të komuniteteve të ndryshme të marginalizuara, IAG-të rishikojnë edhe trajtimin rutinë të rasteve, si dhe çështje të tjera siç janë statistikat e ndalimit/kontrollit nga policia.

Gerallt Evans, një kryeprokuror në Angli dhe në Uells, nënvizoi rëndësinë e strukturave të këtylla për rritjen e e besimit të komunitetit dhe të publikut të gjerë, gjë që përbën një kontribut për të siguruar që CPS do të jetë në gjendje të veprojë në mënyrë efektive në shkallën e parë:

“Avantazhi është i dyfishtë: si një agjenci, përfiton ekspertizën e anëtarëve të komunitetit, por shpreson gjithashtu që vetë fakti se po propozon të ekspozohesh ndaj kësaj lloji mbikëqyrjeje, do të ndihmojë definitivisht në fitimin e besimit të publikut. Pra, në njëfarë mënyre, është një përfitim i ndërsjellë.”

BURIME TË MËTEJSHME

Shoqata për të Drejtat e Barabarta të Komunitetit LGBTI për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (ERA) – Qendra e Burimeve në Internet

www.lgbti-era.org/online-resource-center

NDI (2015) Sondazh për çështjet LGBT në Ballkanin Perëndimor

www.ndi.org/LGBTI_Balkans_poll

ILGA-Europe (2010) Joining Forces to Combat Homophobic and Transphobic Hate Crime. Cooperation between Police Forces and LGBT Organisations in Europe

www.ilga-europe.org/sites/default/files/Attachments/ilga-europe_cooperation_between_police_forces_and_lgbt_org_in_europe.pdf

ILGA-Europe (2011) Toolkit for Training Police Officers on Tackling LGBTI-phobic Crime

www.ilga-europe.org/resources/ilga-europe-reports-and-othermaterials/ilga-europe-toolkittraining-police-officers

OSBE ODIHR – Burimet për Denoncimin e Krimeve të Urrejtitjes

hatecrime.osce.org

Këshilli i Evropës (2017) Policing Hate Crime Against LGBTI Persons: Training for a Professional Police Response

rm.coe.int/prems-030717-gbr-2575-hate-crimes-against-lgbti-weba4/1680723b1d



Montenegro Pride 2017.
Credit: Queer Montenegro

MANUALI PËR AKSESIN E KOMUNITETIT LGBT NË DREJTËSI

Sfida ndaj dhunës nëpërmjet
angazhimit të komunitetit LGBT

MËSIMET NGA AKTIVISTËT E TË DREJTAVE TË
KOMUNITETIT LGBT NË BALLKANIN PERËNDIMOR
DHE NË MBRETËRINË E BASHKUAR

Funded by



Foreign &
Commonwealth
Office

Stonewall,
192 St John Street,
London EC1V 4JY
info@stonewall.org.uk
www.stonewall.org.uk
Registered Charity number 1101255
PUBLISHED BY STONEWALL, 2018



Stonewall
Acceptance without exception